



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1265/prot.,  
6

Tiranë, më 26 .05 .2021

VENDIM

Nr. 42 , datë 26 .05 .2021

PËR

**MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, QË PËRFITOJNË BURSË DHE PËRFITOJNË PËRJASHTIM NGA TARIFA E SHKOLLIMIT, ME NOTË MESATARE 9-10, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021, QË STUDIOJNË NË NJË PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË PARË DHE PROGRAM STUDIMI TË INTEGRUAR, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË**

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave VKM nr.903, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë.”, i ndryshuar , të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.269, datë 29.03.2017, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” të ndryshuar,” Bordi i Administrimit pasi mori në shqyrtim relacionin e Administratorit të UMT-së nr.1183/1 prot, datë 27.05.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë listen për 1 studentë me notë mesatare 9-10, që përfiton bursë dhe studion në një program studimi të ciklit të parë dhe në një program studimi të integruar në Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Efekti financiar për këtë studentë është është 85,000 (tetëdhjetë e pesëmijë) lekë dhe përballohet nga fondet grant të buxhetit të shtetit.
3. Të miratojë listën për 1 student, me notë mesatare 9-10, nga viti i dytë e lartë, që përfiton përjashtim nga tarifa e studimit, në një program studimi të ciklit të parë dhe në një program studimi të integruar në Fakultetin e Mjekësisë, të Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2020-2021, bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Të miratojë efektin financiar që rrjedh nga miratimi i kësaj liste, në vlerën 45,000 (dyzet e pesëmijë) lekë, vlerë e cila do financohet nga fondet grant të buxhetit të shtetit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë për zbatimin dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të Institucionit.

**KRYETARI**

**Prof. Florian TOPI**



**FAKULTETI I MJEKËSISË**

**LISTA E STUDENTEVE VITI I KATËRT MSC MJEKËSI E PËRGJITHSHME  
STUDENTË EKSELENTË MESATARE 9-10 VITI AKADEMIK 2020-2021**

<b>NR.</b>	<b>EMËR</b>	<b>ATËSIA</b>	<b>MBIEMRI</b>	<b>KREDITE TE MARRA TË VITIT PARAARDHËS</b>	<b>MESATARE E PONDERUAR</b>
1	Stela	Romeo	Janko	60	9.05